



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 07.11.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.11.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Construmax SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “**Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime**” me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e jashtafatshme kërkesa për rishqyrtim e OE **Construmax SH.P.K.** e datës 07.11.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime**” me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1, kundër Njoftimit për Kontrate, të datës 17.10.2024 te publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi për Kontrate i datës 17.10.2024 dhe Formulari standard per korrigjim-B54 i dates 01.11.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik **Construmax SH.P.K.** me datë 07.11.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i objektit te ri për Institutin Special ne Shtime**” me nr. prokurimi 206-24-187-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 07.11.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

- Neni 1 i LPP-së
- Neni 7 i LPP-së
- Neni 27 i LPP-së
- Neni 38 i LPP-së
- Neni 69 i LPP-së
- Neni 71 i LPP-së
- Neni 18.9 i RRUOPP-së
- Neni 26.4 i RRUOPP-së.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me kërkesën për rishqyrtim te OE ankues:

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, para 3. i cili thekson:

“3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

Operatori Ekonomik ankues ka dorëzuar Kërkesë për rishqyrtim me datë 07.11.2024, ndërsa hapja e ofertave ka qene e parapare me datën 12.11.2024.

Dita e Kërkesës për rishqyrtim, data 07.11.2024 eshte dita zero (0) sipas nenit 63.2 te RRRP;

Dita e parë (1) eshte 08.11.2024, dita e dyte 09.11.2024, dita e trete eshte 10.11.2024, dita e kater eshte 11.11.2024, dita e hapjes se ofertave 12.11.2024.

Dita e dorëzimit te ofertave është dita zero (0), qe i bie se janë vetëm kater dite ne mes këtij afati.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.2. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që ka parashtruar ankesë pas afatit te fundit te lejuar 5 dite para dorëzimit te ofertave.

Nenin 60.1(a) i Rregullave te prokurimit publik

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njollimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Nenin 63.2 i Rregullave te prokurimit publik

Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtroj një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).

AK hedh poshtë ankesën e parashtrua ne përputhje me nenin 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 cili nen përcakton se:

Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Construmax SH.P.K.
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

ZPP, Udhëheqës i Div. te Prokurimit